126
128/23

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 557/23
Datë/Datum. 23.05.2023.
PRISHTINË - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 195/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve "Bekim H. Mazreku" B.I., me emër tregtar N.T.Sh. "Delfina", me numër unik identifikues 81070736, me seli në Malishevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura "Krasniqi & Partners" Sh.p.k., me seli në Prishtinë, kundër të padituruve Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Agjencia Qendrore e Prokurimit, me seli në Prishtinë dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. "Migjeni", për shkak të anulimit të Vendimit të datës 28.02.2023 dhe Vendimit PSH. nr. 126, 128/23 të datës 27.04.2023 dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit PSH. nr. 126, 128/23 të datës 27.04.2023, jashtë seancës, më datë 19.05.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar propozimi i paditësit "Bekim H. Mazreku" B.I., me emër tregtar N.T.Sh. "Delfina", me seli në Malishevë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

II. SHTYHET ekzekutimi i pikës 2 të Vendimit PSH. nr. 126, 128/23 të datës 27.04.2023 i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

III. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar propozimi i paditësit "Bekim H. Mazreku" B.I., me emër tregtar N.T.Sh. "Delfina", me seli në Prishtinë për shtyrjen e ekzekutimit të pikës 1, të vendimit PSH. nr. 126, 128/23 të datës 27.04.2023 i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit.

A r s y e t i m

Paditësi "Bekim H. Mazreku" B.I., me emër tregtar N.T.Sh. "Delfina", me seli në Malishevë, përmes përfaqësueses së tij me autorizim, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Vendimit të datës 28.02.2023 i nxjerrë nga Agjencia Qendrore e

Prokurimit dhe Vendimit PSH. nr. 126, 128/23 të datës 27.04.2023 i nxjerrë nga i padituri i dytë Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSH. nr. 126-128/23 të datës 27.04.2023, deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga gjykata.

Paditësi, në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartcekur, lidhur me plotësimin e kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit ka theksuar se caktimi i masës është i domosdoshëm për arsye se propozuesit i shkaktohet dëm për faktin se të njëjtit i mohohet e drejta e fitimit të tenderit për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me inventar zyrtar tavolina pune dollap dhe karrige" Lot 1 dhe Lot 2 me numër UA/2016-22-14086-1-1-1. Gjithashtu ka theksuar se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit do të mbrohej e drejta e paditësit dhe do të mbrohej edhe interesi publik për arsye se në referatin e padisë janë sqaruar shkeljet e AK dhe OSHP lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe për shkak të këtyre shkeljeve ekzekutimi i vendimit kontestues do ti sjell dëm palës paditëse por edhe vetë AQP-së si organ publik. Ka shtuar se paditësit i shkaktohet dëm edhe përmes pikës II të dispozitivit të vendimit kontestues pasi që me konfiskimin e mjeteve të tarifës ankimore të njëjtat kundërligjshëm kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës ashtu që gjykatës i ka propozuar që në rast se nuk plotësohen kushtet ligjore për caktimin e masës, të njëjtën ta caktojë edhe pjesërisht vetëm për pikën II të dispozitivit të vendimit PSh.nr. 126/23 dhe Psh.nr. 128/23 të datës 27.04.2023 në mënyrë që pala paditëse të mos e humb afatin ligjor 60 ditor për të paraqitur kërkesën për kthimin e këtyre mjeteve.

Me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: "*Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar*". Po ashtu në paragrafin 6 përcaktohet se "*Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni*" dhe nenit 27 par. 1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale i cili përcakton se "*Jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e një kërkese për masë të përkohshme ose lehtësim tjetër urgjent, në përputhje me ligjet në fuqi, dhoma e shkallës së parë e konsideron dhe vendos për një kërkesë të tillë pa dëgjim të palëve në seancë*"

Bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi pasi që paditësi pretendimet e paraqitura në propozim i ka mbështetur në argumente të qëndrueshme.

Gjykata pasi vlerësoi propozimin e paditësit, shkresat e lëndës dhe vendimin kontestues, vlerësoi se ekzekutimi i vendimit kontestues në pikën 2 paditësit do ti sillte dëme vështirë të riparueshme pasi që mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore do të konfiskohen dhe do të kalonin në Buxhetin e Republikës së Kosovës, për çfarë paditësit do ti pamundësohej kthimi i të njëjtave në rast se në fund të procedurës rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata po ashtu gjeti se kërkesa e paditësit për shtyrjen e pikës 2 të vendimit kontestues nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare e as palës së interesuar pasi që këto mjete kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe janë të hyra të paplanifikuara më parë, ashtu që shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk do të paraqiste mungesë në ndonjë linjë buxhetore.

Gjykata refuzoi pjesërisht si të pabazuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktvendimi pasi që vlerësoi se nuk janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore në mënyrë kumulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, përkatësisht nuk është vërtetuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit për pikën 1të vendimit kontestues nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe se shtyrja nuk do ti shkaktonte dëm të paditurit përkatësisht personave të interesuar, pasi që është në interes publik që të përfundohet realizimi i aktivitetit të prokurimit "*Furnizimi me invertar zyrtar tavolina pune, dollap dhe karrika*" me nr. prot. UA/2016-22-14086-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit, ndërsa shtyrja e ekzekutimit të vendimit do të pamundësonte Autoritetit Kontraktues që të realizojë këtë aktivitet të prokurimit apo që të zhvillojë procedurë tjetër tenderuese për aktivitetin e lartcekur të prokurimit.

Prandaj, gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, ndërsa lidhur me pretendimet tjera të paraqitura në padi, gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave të propozuara dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë, por që këto pretendime dhe prova nuk ishin me ndikim me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit për pikën 1 të vendimit kontestues.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr. 195/23, datë 19.05.2023

Gjyqtari

Arnis Dumani

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA KOMERCIALE KOMERCIJALNI SUD REPUBLIKA KOSOVA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.